



HAL
open science

Shfaqja e Antropologjisë Heroike në Historinë e Ideve

Albert Doja

► **To cite this version:**

Albert Doja. Shfaqja e Antropologjisë Heroike në Historinë e Ideve. Polis, 2008, 7, pp.131-148.
halshs-00448643

HAL Id: halshs-00448643

<https://shs.hal.science/halshs-00448643v1>

Submitted on 19 Jan 2010

HAL is a multi-disciplinary open access archive for the deposit and dissemination of scientific research documents, whether they are published or not. The documents may come from teaching and research institutions in France or abroad, or from public or private research centers.

L'archive ouverte pluridisciplinaire **HAL**, est destinée au dépôt et à la diffusion de documents scientifiques de niveau recherche, publiés ou non, émanant des établissements d'enseignement et de recherche français ou étrangers, des laboratoires publics ou privés.

*Shfaqja e antropologjisë heroike në historinë e ideve*¹

Albert Doja²

ABSTRAKT. Në këtë artikull shpjegohet kontributi i Claude Lévi-Strauss-it në antropologji. Lévi-Strauss-i e shndërroi antropologjinë në një projekt shkencor me një vlerë shumë më të sofistikuar intelektuale për të kuptuar njerëzimin sesa ç'mendohet apo sesa ka arritur më parë kjo fushë. Kontributi i tij përfaqëson rithithjen e kësaj fushë në qendrën e ideve perëndimore, përderisa ai e riformuloi antropologjinë si një projekt intelektual, një profesion të intelektualëve të kohës, në vend të një profili të specializuar me gjuhën, të dhënat, metodat, teknikat, dhe teoritë e tij të ralla. Sipas Clifford Geertz-it, asnjë antropolog nuk ka qenë më insistues sesa Lévi-Strauss-i në faktin se “praktika e profesionit të tij përbëhet nga një kërkim personal i drejtuar, nga një vizion personal dhe që synon shëlbimin personal.”³ Në formën e mitit standard profetik të një kërkimi heroik me antropologun si hero, sipas Richard Shweder-it, Lévi-Strauss-i e shndërroi ekspeditën e tij në brendësinë e virgjër të Amazonës në një kërkim vizioni dhe e shndërroi antropologjinë në një mision shpirtëror për të mbrojtur njerëzimin kundër vetvetes.

Hyrje

Është thënë shpesh se Radcliffe-Brown dhe Malinowski pak a shumë me një goditje krijuan antropologjinë moderne. Kjo mund të ketë qenë e tillë në mesin e shekullit të njëzetë, kur antropologjia Boas-iane ishte shpërndarë në disa degë të specializuara ndërsa studentët e Marcel Mauss-it nuk e kishin lënë akoma gjurmën e tyre të ndjeshme në antropologjinë franceze. Studimet

1 Ky artikull është botuar për herë të parë në revistën *Journal of the History of Ideas*, vol 66 (4), 2005, pp. 633–650. Ai ri- botohet me rastin e njëqind vjetorit të lindjes së Claude Lévi-Strauss-it.

2 Dr. Albert Doja ka punuar në një sërë institucionesh kërkimore dhe në disa universitete perëndimore në Francë dhe në Angli, si University of Hull, University of Limerick, etj. Ai ka qenë gjithashtu edhe zv.Rektor i Universitetit të Durrësit. Dr. Doja ka botuar një sërë artikujsh shkencorë në disa nga revistat më serioze akademike në Britani dhe Francë. Për momentin ai gjithashtu jep mësim në Universitetin European të Tiranës (UET).

3 Geertz, *The Interpretation of Cultures*, 346.

Britanike të farefnisnë dukeshin në atë kohë të rrënjosura fort në metodën etnografike të Malinowski-t dhe teorinë e zhvilluar prej Radcliffe-Brown; këto studime ishin konsoliduar si një “shkencë e shoqërisë”. Sipas Eriksen dhe Nielse, antropologjia pësoi ndryshime thelbësore në vitet 1950-1960. Ri-konceptualizimet në ekonomi dhe politikë si dhe teori të reja mbi domethënien simbolike e transformuan këtë disiplinë.¹ Zhvillimet në Amerikën Veriore dhe Britani ishin të ndryshme nga njëra tjetra, por problemet e ngritura ishin shumë të ngjashme, prapëseprapë teoricieni i vetëm më i rëndësishëm ishte Francez.

Shpërthimi i Claude Lévi-Strauss-it që në vitet e para pas luftës si një mendimtar ekzemplar, si figura më e rëndësishme në historinë e antropologjisë dhe si antropologu “ekumenik” dhe “shembullor” i pjesës së dytë të shekullit të njëzetë, rrjedhimisht që luajti një rol shumë të rëndësishëm në rrethet intelektuale bashkëkohore dhe në disiplinën e antropologjisë në veçanti.² Në vitet 1950-të dhe 1960-të, për shumë arsye, jo më pak se vetë promovimi i mprehtë që Lévi-Strauss-i i bëri në rrethe më të gjera intelektuale, antropologjia u shndërrua në një nga pikat më të rëndësishme të referencës në diskutimet intelektuale në Francë, duke marrë pjesë në idetë më tërheqëse të asaj kohe që përkufizoheshin si strukturalizëm, i cili kishte si ambicie që të pajiste shkencat shoqërore me një rigorozitet dhe forcë të krahasueshme me atë të shkencave natyrore.

Për më tepër, audienca e “pashoqe” intelektuale dhe fama ndërkombëtare që Lévi-Strauss-i ka arritur në antropologji ka influencuar jashtëzakonisht jo vetëm antropologjinë, por edhe degë të tjera të dijes humane, që nga historia dhe psikoanaliza deri te filozofia dhe studimet letrare. “Kontributi i punës së tij mbi konceptin e kulturës, mbi kuptimin tonë të gjuhës dhe proceseve mendore, të interpretimit tonë të historisë është aq direkt dhe inovator saqë, sipas George Steiner-it, njohuria mbi Lévi-Strauss-in është bërë pjesë e njohurive të përgjithshme që duhet t’i ketë kushdo.”³ Puna e tij ka sjell një shkëputje epistemologjike me metodat e mëparshme analitike dhe kjo mund të quhet edhe si një revolucion antropologjik.

Një aspekt i nënvlerësuar i punës së Lévi-Strauss-it është se formulimi i tij origjinal i metodës strukturaliste trajtonte probleme specifike rreth pozitës së antropologjisë si fushë, jo vetëm probleme të teorisë antropologjike, por më gjerësisht të çështjes së natyrës dhe kompetencave të antropologjisë dhe të raportit të saj me shkencat e tjera humane. Duket se Lévi-Strauss-i synon gjithmonë të thotë diçka më të përgjithshme mbi natyrën e fushës që ai praktikon, mbi pikat e saj të referencës dhe kërkesat e saj shkencore dhe humaniste, në një mënyrë esencialisht gjithëpërfshirëse të të menduarit.⁴ Ai nuk mjaftohet që të shprehet vetëm në emrin e vet dhe në emrin e perceptimit të tij lokal, por është i aftë të shprehet edhe në emër të një kolektivi, në emrin e antropologjisë,

1 Thomas H. Eriksen and Finn. S. Nielsen, *A History of Anthropology* (London: Pluto Press, 2001), 95.

2 Stanley Diamond, “The Inauthenticity of Anthropology: The Myth of Structuralism,” in *In search of the Primitive: A Critique of Civilization* (New Brunswick, NJ.: Transaction Books, 1974), 292-331.

3 George Steiner, *Language and Silence: Essays on Language, Literature and the Inhuman* (London: Faber, 1967), 250.

4 Johnson, Claude Lévi-Strauss, 181.

në mbrojtje të asaj çka beson të jetë kontributi i tij i veçantë në dijen bashkëkohore, aq sa përfundimet e tij kanë kontribuar “më tepër në ndryshimin e sensit të antropologjisë mbi veten sesa të sensit të saj mbi subjektin e saj.”¹ Aftësia për të bërë sinteza, vështrim të përgjithshëm, thënie reflektive mbi atë çka është një fushë e caktuar dijesh dhe se çfarë mund të jetë ajo, është një nga tiparet thelbësore të Lévi-Strauss-it, i cili nuk është thjesht riprodhues idesh dhe teorish, por, në mënyrë të padiskutueshme, një mendimtar me shumë influencë, një *maitre a penser* (mjeshtër mendimi).

Lévi-Strauss-i e shndërroi antropologjinë në një projekt shkencor me një vlerë shumë më të sofistikuar intelektuale për të kuptuar njerëzimin sesa ç’mendohet apo sesa ka arritur më parë kjo fushë. Kontributi i tij përfaqëson rithithjen e kësaj fushe në qendrën e ideve perëndimore, përdërisa ai e riformuloi antropologjinë si një projekt intelektual, një profesion të intelektualëve të kohës, në vend të një profili të specializuar me gjuhën, të dhënat, metodat, teknikat dhe teoritë e tij të ralla. Zhvillimi i vetë strukturalizmit është historikisht i pandashëm nga prestigji i antropologjisë. Strukturalizmi lindi si një alternativë ndaj marksizmit dhe fenomenologjisë, dhe impakti i tij në përgjithësi mbi jetën intelektuale ishte të paktën po aq i theksuar sa në antropologji. Në Francë, studiues të rëndësishëm si Lakan, Barthes, Foucault, dhe Bourdieu u ushqyen me strukturalizmin, u rebeluan kundër tij, dhe rebelimi i tyre është njohur dhe debatuar nga antropologë që i përfshinë këta autorë në veprat klasike të antropologjisë.

Konteksti intelektual

Në Francë, me botimin e *Të Qënurit dhe Asgjëja* dhe *Fenomenologjia e Perceptimit*, fenomenologjia mbizotëronte jetën intelektuale në formën e ekzistencializmit, i cili arriti të bëhej një lëvizje gjithëpërfshirëse filozofike nën drejtimin karizmatik të Jean Paul Sartre-it.² Fenomeni i strukturalizmit tërhoqi vëmendjen e inteligjencës pariziane nga fundi i viteve 1950 dhe 1960 dhe vendosi kornizat e debatit intelektual për një dekadë të tërë. Debatet që zhvilloheshin rreth ekzistencializmit dhe strukturalizmit në vitet 1960 përbënin një kundërvënie dialektike tipike midis shkollave të ndryshme të mendimit që kishte qenë një tipar konstant i jetës intelektuale në Francë.³ Me kombinimin e tij të shkencës me humanizmin, strukturalizmi u konsiderua si pasardhësi i logjikshëm i ekzistencializmit. Vëllimi i parë i *Antropologjisë Strukturale*⁴ të Lévi-Strauss-it në njëfarë mënyre u shfaq në atë kohë si manifestoja e strukturalizmit dhe për Lévi-Strauss-in atëhere flitej si për një

1 Clifford Geertz, *Works and Lives: The Anthropologist as Author* (Stanford, Calif.: Stanford University Press, 1988), 25.

2 Jean Paul Sartre, *L'Être et le Néant: essai d'ontologie phénoménologique* (Paris: Gallimard, 1943); Maurice Merleau-Ponty, *Phénoménologie de la perception* (Paris: Gallimard, 1945).

3 Johnson, *Claude Lévi-Strauss*, 107-8.

4 Claude Lévi-Strauss, *Antropologie Structurale* (Paris: Plon, 1958).

filozof, si themeluesin e strukturalizmit, në të njëjtën mënyrë që Sartre-i konsiderohej themeluesi i ekzistencializmit.

Strukturalizmi ishte një reagim ndaj prirjes dominuese të fenomenologjisë në filozofinë franceze në vitet e pasluftës. Në këtë kuptim, është e pamundur të kuptohet sukcesi fenomenal i strukturalizmit në Francë pa iu referuar hegjemonisë së mëparshme të ekzistencializmit. Strukturalizmi, pra është një refuzim pikë për pikë i ekzistencializmit. Në përgjithësi, filozofët e pasluftës e të njëjtës gjeneratë si Lévi-Strauss-i formuluan të njëjtat kundërshtime si ai ndaj filozofisë tradicionale, me një fjalë ndaj sistemit të kontrasteve të rreme dhe të pakapërcyeshme midis subjektit dhe objektit që gjithmonë riprodhojnë të njëjtat koncepte të ngushta dhe që pengojnë çfarëdolloj pune kërkimore. Por një koshiencë që ishte reduktuar në shprehjen karteziante “unë mendoj”, fenomenologjia e zëvendësoi me një koshiencë që i hapej eksperiencës trupore dhe ngjarjeve historike. Subjekti ishte i preکشëm nëpërmjet perceptimit dhe eksperiencës. *Cogito* e Descart-it ia la vendin *percipio* –s të Merleau-Ponty-s, *praxis* të Sartre-it dhe *gramma* të Derrida-së. Për më tepër, ndërsa ekzistencializmi i Sartre-it dhe gramatologjia e Derrida-së ishin të rrënjosura në terrenin e zakonit të filozofisë perëndimore, për Lévi-Strauss-in projekti i antropologjisë strukturale dhe shkencat shoqërore përbënin një shkëputje nga metafizika, një refuzim të problemeve tradicionale filozofike në mënyrë që të ndiqej një hulumtim shkencor i sjelljes njerëzore.

Strukturalizmi mbi të gjitha ishte mishërimi i një gare dhe korrespondonte me një moment të historisë perëndimore ku shprehej një urrejtjeje ndaj vetvetes, një refuzim i kulturës tradicionale perëndimore, dhe një shpresë për një modernizëm në kërkim modelesh të reja. Strukturalizmi i kundërvuri glorifikimit të vlerave të vjetra një lloj ndjeshmërie ndaj gjithçkaje të shtypur gjatë historisë perëndimore, të kundërtën e domethënies së shprehur, anën e represionuar dhe të pakapshme të natyrës njerëzore. Foucault-ja, në veprën e tij *Fjalët dhe Sendet*, saktësisht e përshkroi psikoanalizën e Lacan-it dhe antropologjinë e Lévi-Strauss-it si të frymëzuara “nga parimi i vazhdueshëm i ankthit, i ngritjes së pikëpyetjeve, i kritikës dhe kontestimit të gjithçkaje që duket si e natyrshme.”¹ Nga ky këndvështrim, zgjedhja e modelit lingistik nga Lévi-Strauss-i nuk është e rastësishme pasi një nga parimet më revolucionare që lingvistika strukturale ka sjellë në metodologjinë shkencore është pikërisht zhvendosja e fokusit kërkimor nga niveli i lingustikës koshiente në atë të infrastrukturës subkoshiente. Mënyra e konceptualizimit të marrëdhënieve subkoshiente që zbulon analiza strukturale e Lévi-Strauss-it është intuitivisht përfytyrimi më i kuptueshëm i subkoshiencës.²

Rënia e fuqive evropiane dhe valët e dekolonizimit pas Luftës së Dytë Botërore ndikuan që shumë veta të vinin në pikëpyetje vlerat, superioritetin e kulturës dhe koshiencës evropiane duke kritikuar etnocentrizmin e saj. Në këtë kontekst ishte mëse logjike që antropologjia, në rolin e saj ndërmjetësues të kulturave jo-perëndimore, të bëhej vatra e këtyre kritikave dhe pikëpyetjeve. Në fakt, antropologjia strukturale justifikohet si një

1 Michel Foucault, *Let mots et les choses: une archeologie des sciences humaines* (Paris: Gallimard, 1966), 385.

2 Claude Lévi-Strauss, “L’analyse structurale en linguistique and en anthropologie,” in *Anthropologie structurale* (Paris: Plon, 1958), 40.

shkencë humane e kulturave jo-perëndimore falë eksperiencës moderne të tjetërsimit (alienimit) dhe sjell pra një formë alternative humanizmi. Ky humanizëm i ri që Lévi-Strauss-i synoi ta përcjellë në “tërë përmasat e njerëzimit” ndërthur ambicien për një analizë shkencore me detyrimin për një ndërgjegje globale.¹ Vizioni i njerëzimit sipas Lévi-Strauss-it ishte më i gjerë sesa ai i humanizmit të filozofisë tradicionale. Duke u fokusuar në konceptin e individit si karakteristike kulturore, ai përmbushte akoma më mirë atë universalizëm që pretendonte humanizmi i vjetër.

Në fakt, humanizmi i vjetër, siç mishërohej në figurën e Sartre-it, dukej krahasimisht më i ngushtë, si në kufizimin e tij mbas një tradite specifike të filozofisë perëndimore, ashtu edhe në mungesën e interesit ndaj zhvillimeve të reja të shkencës bashkëkohore. Humanizmi i ri i antropologjisë së Lévi-Strauss-it ndërthuri rigorozitetin shkencor me një vizion më të gjerë të njerëzimit, duke vepruar njëkohësisht si ndërgjegje dhe koshiencë e civilizimit perëndimor, ndërsa përcaktonte një rol më modest për individin.

Në këtë kuptim, misioni shkencor i antropologjisë strukturale nuk mund të përjashtojë marrjen në konsideratë të çështjes së vlerave dhe të ideologjisë. Për Lévi-Strauss-in, antropologjia strukturale si shkencë humane dhe si humanizëm nuk janë në kundërshtim me njëra tjetrën. Ndërthurja e epistemologjisë me etikën tek vepra e Lévi-Strauss-it, në mënyrën sesi ai e ndërthurte eksperiencën e tij jetësore me punën e tij teorike, zotëron një përmbledhje didaktike dhe një unitet metodologjike që shkon përtej programit të ngushtë shkencor të strukturalizmit. Është e evidente se paradigma e antropologjisë strukturale nuk mundet thjesht të njehsohet me fushën e strukturalizmit, por përbën diçka komplet tjetër dhe më komplekse.

Që nga vitet 1960, strukturalizmi lulëzoi edhe në fusha të tjera dhe shumë shpejt u shndërrua në një formë (shpesh të kritikueshme) mode intelektuale, filozofike dhe letrare me të gjitha shtrembërimet dhe thjeshtëzimet që shoqërojnë këtë lloj popullarizimi. Lévi-Strauss-i gjithmonë e distancoi veten dhe ia mohoi atësinë e tij pasioneve ideologjike që i hapën rrugën modës strukturaliste. Ai vazhdimisht insistonte se strukturalizmi që u zhvillua në Francë në fund të viteve 1950 dhe fillimi i viteve 1960 duhet të dallohej nga ai strukturalizëm që ai u përpoq të arrinte në antropologji.

Shpesh atij i kërkohet të përshkruante fusha dijesh, të cilat ai nuk i zotëronte mirë, metoda që ai nuk i njihnte ose këndvështrime që nuk kishin asnjë të përbashkët me karakterin teknik të punës së tij kërkimore. Së fundi, ai e kuptoi sesi këto lloj modash intelektuale mund të dëmtonin publikisht dhe akademikisht rigorozitetin dhe vlerësimin e qetë të punës së tij. Ishte kjo arsyeja përse ai në shumicën e rasteve vendosi të rrinte i tërhequr dhe larg kësaj zhurme intelektuale. Padyshim i preokupuar që të kishte kontroll mbi trashëgiminë e punës së tij, ai mjaftohej vetëm me korigjime të sulmeve të keqinformuara mbi praktikën e tij rreth analizës strukturale, dhe përfshihej vetëm në debate në antropologji apo në fushat e përafërta, të cilat shtronin pyetje precize dhe kritika me vend ndaj ti dhe ndaj vetes së tyre.

1 Claude Lévi-Strauss, “Le champ de l’antropologie,” in *Antropologie structurale deux* (Paris: Plon, 1973 [New York: Basic Books, 1976]), 44 [32].

Për Lévi-Strauss-in strukturalizmi s'ishte gjë tjetër veçse një kornizë e ngushtë e një projekti brilant. Në thelb, vepra e tij është njëkohësisht më modeste, më e kujdesshme, dhe shumë më domethënëse për dijen antropologjike, edhe pse stili i saj mbetet një përzierje baroke e ekuilibrit me gjallërinë shpotitëse. Edhe nëse strukturalizmi mund të ketë pasur njëherë e një kohë një rol të dobishëm, sot për sot ai është kthyer në një pengesë e zhvillimit të plotë të ideve për të cilat antropologjia i mbetet borxhlike Lévi-Strauss-it. Qasja e tij huazoi më pak parime të përgjithshme sesa një qëndrim intelektual egzigjent dhe guximtar. Falë këtij qëndrimi dhe një sërë intuitash të mprehta, puna teorike i ofroi atij mundësinë joshëse për të kërkuar rregull dhe kaos dhe për të dhënë një kontribut shumë të përgjithshëm, por edhe shumë personal ndaj antropologjisë.

Nëse antropologjia kulturore konsiston në studimin e rregullave dhe shpalosjen e ligjeve nëpërmjet analizës së disa aspekteve të jetës sociale apo të materializimit kulturor vlefshmëria e të cilëve testohet edhe në aspekte të tjera, atëherë nuk është një pyetje e strukturalizmit ideologjik ajo që do të sillte një mesazh apo të ofronte një filozofi të përgjithshme mbi njeriun. Qasja epistemologjike e Lévi-Strauss-it synon të jetë veçse një metodë rigorozë që i afrohet dijes shkencore dhe që thjesht kërkon të shtojë një nivel rigoroziteti në një fushë studimi ku kjo ka munguar më parë. Disa pjesë të veprës së tij pa dyshim i afrohen ekselit të optimizimit metodologjik, ku analiza strukturale në dukje shkrihet me vetë shkencën, mënyrat mbretërore të së cilës, përfshirë këtu edhe matematikën, përfundimisht iu hapën fushave të dijes që deri tani kishin qëndruar rebele. Gjithsesi ai nuk përzieu asnjëherë skemën e një sistemi të ri dogmatik me frymëzim shkencor me disa digresione më personale që ai këndshëm i cilësoi si “shkelje pa leje në territorin e gjuetisë së filozofisë,” pavarësisht thellësisë së mendimit që mund të shprehnin ato.

Thithja dhe zhvillimi i teorive stimuluese dhe të diskutueshme të Lévi-Strauss-it tërhoqën vëmendjen e një sërë antropologëve të talentuar jo vetëm në Francë, por edhe në Britani e më tej. Një nga ironitë e historisë së interpretimit të veprës së Lévi-Strauss-it në antropologji është se ai shpesh është kritikuar nga kolegët e tij francezë për lidhjen e tij të panevojshme me traditën “anglo-saksone”, ndërsa kolegët e tij anglisht-folës e kanë kritikuar atë për tendencën e tij “franceze” për të spekuluar, abstraguat dhe përgjithësuar.¹

Edhe pse antropologjia britanike është mësuar tanimë me huazimin e teorive nga Franca, vepra e Lévi-Strauss-it arriti një abstraksion të atillë sa që hezitimi pothuajse i natyrshëm britanik mund të tejkalohet vetëm nga elokuenca shpotitëse e Edmund Leach-it. Ndër të tjera, në hyrjen e një botimi me ese nga antropologë britanikë që aplikonin teoritë e mitit the totemizmit nga Lévi-Strauss-i, Leach-i komentoi se disa nga kontribuesit nuk dukeshin se kishin lexuar ndonjë gjë të Lévi-Strauss-it dhe që kritika e tyre varej “ose nga arroganca angleze ose thjesht nga keqinformimi.”² Ishte

1 Johnson, *Claude Lévi-Strauss*, 9.

2 Edmund Leach (ed.), *The Structural Study of Myth and Totemism, A.A.A. Monographs*, 5 (London: Tavistock, 1967), xv.

pikërisht kjo paraqitje e shkrimeve të Lévi-Strauss-it, mbase më cilësorja ndër shumë të tjera, e cila e zgjeroi shumë njohurinë e veprës së Lévi-Strauss-it në botën anglisht-folëse.¹

Leach-i ka qenë antropologu më entuziast dhe krijues britanik që eksperimentoi me aplikimin e metodave strukturale ndaj tematikave të reja antropologjike dhe që u përpoq shumë për t'i bërë idetë e strukturalizmit të kuptueshme për një publik të gjerë.² Lévi-Strauss-i vetë ka komentuar shumë mbi farefisninë ndër Kachin (objekti i studimit të Leach-it) ndërsa Leach-i e kishte kuptuar menjëherë vlerën e përfundimeve të Lévi-Strauss-it edhe për studimet e tij.³ Ashtu siç rrefeu edhe vetë më vonë, “ajo çka më habiti në atë kohë ishte fakti se Lévi-Strauss-i kishte perceptuar shumë më qartë se unë disa tipare thelbësore të strukturës së shoqërisë Kachin.”⁴ Rodney Needham-i ishte gjithashtu një entuziast i Lévi-Strauss-it, edhe pse me pak rezerva, të cilat u forcuan edhe më tepër nga vetë Lévi-Strauss-I, i cili e hidhte poshtë interpretimin e teorisë së tij të farefisnisë nga Needham-i. Të gjitha rezervat e këtij të fundit jo vetëm që nuk u zhdukën, por përkundrazi ato morën formën e një çështjeje kombëtare dhe shumë antropologë britanikë iu kundërvunë Lévi-Strauss-it me ashpërsi. Edhe pse shumë më pozitiv ndaj Lévi-Strauss-it, Leach-i gjithashtu ngriti shumë polemika kundër tij, shpeshherë shumë provokative.

Tek strukturalizmi, ama, Leach-i dhe shumë të tjerë zbuluan një alternativë shumë të sofistikuar të empirizmit britanik. Jo rastësisht, pasioni britanik për antropologjinë strukturale të Lévi-Strauss-it shoqërohej nga një refuzim pothuajse organik i funksionalizmit struktural të Radcliff-Brown-it. Needham-i⁵ i dedikoi këtij të fundit një mëri patologjike ndërsa në leksionin Radcliff-Brown në Akademinë Britanike, Leach-i⁶ e paraqiti admirimin e tij për Lévi-Strauss-in si një rrjedhim logjik të përbuzjes që kishte për Radcliff-Brown-in. Suksesi që patën Leach-i dhe Needham-i, dhe më vonë Mary Douglas-i,⁷ në konvertimin e studentëve më të shkëlqyer kundrejt ideve të Lévi-Strauss-it lehtësohej shumë nga entuziasmi pothuajse religjioz i tyre ndaj Lévi-Strauss-it:

1 Edmund Leach, *Claude Lévi-Strauss* (London: Fontana/Collins, 1970)

2 Edmund Leach, *Culture and Communication: The Logic by which Symbols are Connected* (Cambridge: Cambridge University Press, 1976).

3 Edmund Leach, *Political Systems of Highland Burma: A Study of Kachin Social Structure* (Cambridge, Mass: Harvard University Press/London School of Economics and Political Science, 1954)

4 Edmund Leach, “Telstar et les aborigines ou la Pensee sauvage,” in *Anthropology and Society*, ed. Stephen-Hugh-Jones and James Laidlaw (New Haven, Conn.: Yale University Press, 2000), 121.

5 Rodney Needham, *Struktura dhe Ndjenja: Një Rast Testi në Antropologjinë Sociale* (Chicago: University of Chicago Press, 1962).

6 Edmund Leach, “Social Anthropology: A Natural Science of Society? [British Academy Radcliffe-Brown Lecture],” in *Anthropology and Society*, ed. Stephen Hugh-Jones and James Laidlaw (New Haven, Conn.: Yale University Press, 2000).

7 Mary Douglas, *Purity and Danger: An Analysis of Concepts of Pollution and Taboo* (London; Routledge & Kegan Paul, 1966)

“Strukturalizmi arriti të ketë elemente të një lëvizjeje fetare dhe disa nga pasuesit e tij ndjenë se u bënë pjesë e një shoqërie sekrete e atyre që ishin në gjendje të shikonin në një botë të verbërisht. Konvertimi nuk ishte thjesht çështje e pranimit të paradigmës së re. Mbi të gjitha, ishte pothuajse një çështje shëlbimi”.¹

Shtetet e Bashkuara ishin padyshim më pak të përshkueshme nga idetë dhe teoritë e antropologëve francezë, edhe pse Lévi-Strauss-i si “amerikanist i vetë-përfshirë” mund të konsiderohet deri diku si pasardhës i traditës së Franz Boas-it.² Siç na rikujton edhe Adam Kuper-i, kush përveç Boas-it do të merrte mundimin të botonte fletë të tëra me receta embëlsirash me mana të grupit indigjenas Kwakiutl në gjuhën e tyre mëmë, dhe kush tjetër përveç Lévi-Strauss-it do të kishte interes të ri-analizonte këtë material?³ Vërtet se analizat dhe kritikët e Lévi-Strauss-it kanë qenë të zakonshme dhe që vepra e tij është diskutuar nga antropologë amerikanë si dhe nga të tjerët. Ndër të tjera trajtimi më gjithëpërfshirës është kapitulli mbi “të egrin e mënçur” të Clifford Geertz-it, i cili paraqet një rilexim origjinal të veprës së Lévi-Strauss-it.⁴ Marshall Sahlins-i, që fillimisht ishte influencuar nga marksizmi struktural dhe neo-evolucionizmi, është një nga të parët që në kritikën e tij ndaj marksizmit për pamundësinë e tij për të shpjeguar themelet e “shoqërisë tribale” konsideroi strukturalizmin si me avantazhe në këtë aspekt.⁵ Edhe pse ende e pafuqishme që të kapë ndryshimin “struktura është fillimi i urtësisë historike” dhe Sahlins-i ishte nga të parët që u mundua ta bënte antropologjinë strukturale më historike.⁶

Megjithatë, krahina e kulturalizmit ishte në konflikt me idenë se logjika e simbolizmit mund të rridhte prej mendjes njerëzore. Shumica e antropologëve anglo-amerikanë në fakt ishin shumë dyshues ndaj Lévi-Strauss-it. Edhe pse të sfiduar nga supozimet e këtij, ata ishin të revoltuar nga mënyra selektive e zgjedhjes së të dhënave nga Lévi-Strauss-i; të tërhequr nga stili i tij brilant letrar, ata nervozoheshin nga arroganca që ata shihnin si në kontradiksion me humanizmin e Lévi-Strauss-it; dhe të joshur nga pikëpyetjet e tij filozofike, ata ndjenin mosbesim dhe pothuajse turp kur ballafaqoheshin me ngushtësinë në të cilën koncepti i tij i strukturës arrin të kthejë një rrjetë shumëpalëshe të problemeve të simbolizmit dhe historisë njerëzore.⁷ Në një masë të madhe të gjithë u provokuan nga modelet abstrakte dhe të logjikës deduktive dhe, edhe pse ata nuk ishin dakort me presupozimet e pazakonta mbi martesën apo përmbledhje tendencioze të një seleksioni mitesh, shumica mbeten të impresionuar

1 Adam Kuper, *Anthropologists and Anthropology: The Modern British School*, 3rd ed. (London/New York: Routledge, 1996), 215.

2 Regna Darnell, *Invisible Genealogies: A History of Americanist Anthropology* (Lincoln: University of Nebraska Press, 2001), 282.

3 Kuper, *Anthropologists and Anthropology*, 223.

4 Clifford Geertz, *The Interpretation of Cultures* (New York: Basic Books, 1973), 345-59.

5 Marshall Sahlins, *Culture and Practical Reason* (Chicago: University of Chicago Press, 1976).

6 Marshall Sahlins, *Historical Metaphors and Mystical Realities: Structure in the Early History of the Sandwich Island Kingdom* (Ann Arbor: University of Michigan Press, 1981).

7 Eleanor B. Leacock, “Structuralism and Dialectics,” *Reviews in Anthropology*, 5 (1978), 117-28.

nga stili joshës i tij, i cili ndërthur mendime të gjera filozofike, thënie koncize teorike dhe një diskutim mbresëlënës dhe eksplorues të materialit mitik dhe social. Clifford Geertz-i për shembull, pavarësisht “sketicizmit [të tij] të pranuar kundër projektit strukturalist si një program kërkimor” dhe “armiqësisë së hapur [të tij] ndaj këtij projekti si një filozofi e mendjes” bën të qartë se ai e shikon “ndërtimin [nga Lévi-Strauss-i] e një fushe të tërë ligjërimi nga një pikënisje e caktuar si një arritje marramendëse, tërësisht e denjë për vëmendjen e merituar.”¹

Kritika anti-strukturale

Që nga fillimi Lévi-Strauss-i ishte një autor mjaft i diskutuar dhe me influencë, dhe sidomos sfida e tij ndaj antropologjisë pozitiviste ka ende shumë influencë. Megjithë literaturën shumë të gjerë dytësore mbi Lévi-Strauss-in, ende ka shumë debat mbi vlefshmërinë e metodave të Lévi-Strauss-it, të cilat mund të duken si të mundshme në teori, por që paraqesin vështirësi praktike shumë të rëndësishme.

Kritikat e veprës së Lévi-Strauss-it ndahen në dy kategori kryesore, pasi kundërshtarët e kësaj metode nënçmojnë jo vetëm indiferencën në dukje të strukturalizmit ndaj historisë, por edhe modelin e tij kufizues të koshiencës dhe të papërshtatshmërisë së saj empirike. Një nga kritikantët e para serioze, e shprehur fillimisht në polemikat e Jean-Paul Sartre-it në *Kritiken e Logjikës Dialektike*, i drejtohej konceptit të kufizuar të Lévi-Strauss-it për sa i përket historisë.² Kritika më shpartalluese erdhi nga Jacques Derrida-ja në *Gramatologjinë*, ku ai theksoi formalizmin e shtjelluar dhe të gënjeshtërt të universalizmave që supozon strukturalizmi dhe që janë shembuj veçse të miteve të traditës filozofike “fonologjike” dhe “logocentrice” perëndimore.³ Rishtazi dhe në mënyrë metodike Derrida-ja sulmoi strukturalizmin dhe një sërë vepra të Lévi-Strauss-it që i akuzoi se nuk kishin marrë parasysh “lojën” e lirë të kuptimit të shenjës.⁴

Është sidomos çështja e raportit subjekt – objekt aty ku debati është më i ashpër pasi filozofët dyshojnë se Lévi-Strauss-i e redukton njeriun dhe veprat e tij thjesht në një reflektim objektiv. Nga pikëpamja e fenomenologjisë, ata fajësojnë qasjen strukturale për varfërimin e praktikës sociale ose për pazotësinë për të arritur nivelin interpretativ të kuptimit. Eksportuar në botën anglisht-folëse pyetja kritike u bë ajo e inisjativës, e “kush” përdor “çfarë” dhe në ç’masë, “çka” mund të bëhet e pavaruar nga “kush”. Eiseistë dhe filozofë me horizonte të ndryshme e dënuan analizën strukturale si një doktrinë që mohon lirinë prodhimit të kuptimit dhe të autonomisë së praktikës individuale, aftësia vepruese njerëzore kështu bëhej komplet e varur në perceptimin e realitetit dhe ndërëgjegjes nga ligje universale ngritur mbi një logjikë që ekziston paraprakisht.

1 Geertz, *works and Lives*, 27.

2 Jean-Paul Sartre, *Critique de la Raison Dialectique* (Paris: Gallimard: 1960).

3 Jacques Derrida, *De la grammatologie* (Paris: Minuit, 1967).

4 Jacques Derrida, *L'écriture et la différance* (Paris: Seuil, 1967), 409-28.

Ndërsa ekzistencializmi i Sartre-it preokupohej më shumë me eksperiencën e subjektit në botë duke theksuar rëndësinë e situatës historike dhe të nevojës së zgjedhjes dhe përgjegjësisë individuale, strukturalizmi fokusohej në strukturat inkoshiente që paraprinin veprimin individual dhe që rezistonin koincendencën historike, dhe të paktën në parim, qëndronte afër çështjeve të natyrës morale dhe etike. Sartre-i kritikonte abstragimin e analizës strukturale dhe objektifimin që i bënte ajo eksperiencës njerëzore, e cila neglizhonte realitetet dialektike të marrëdhënieve konkrete dhe proceseve historike.¹ Sipas tij, prioriteti që i jepej strukturave autonome dhe inkoshiente e dehumanizonte subjektin dhe përjashtonte çdo mundësi veprimi individual.² “Vdekja e subjektit” ishte në fakt një temë e preferuar e strukturalizmit francez gjatë viteve 1960. Për sa i përket natyrës së izomorfizmit të Lévi-Strauss-it midis ligjeve të universit dhe ato të mendjes, Paul Ricoeur-i u shpreh që në fillim se këtu i bëhej homazh inkoshiencës Kantiane:

“Jo një subkoshiencë frojdiane e impulseve instiktive dhe erotike dhe të forcës së saj të simbolizimit, por një subkoshiencë kategorike dhe kombinuese për sa i përket organizimit të saj, meqë këtu jemi të preokupuar me një sistem kategorik që nuk i referohet një subjekti që mendon; është kjo arsyeja pse strukturalizmi si një filozofi prodhon një lloj intelektualizmi që është thelbësisht anti-reflektiv, anti-idealit dhe anti-fenomenologjik”.³

Strukturat synojnë përputhjen nëpërmjet predispozitave mendore hipotetike që reflektojnë njëra-tjetrën dhe duke reflektuar njëra tjetrën në mënyra të ndryshme. Në skemën e Lévi-Strauss-it duket të mos ketë ndonjë ndryshim në zhvillim, por thjesht permutacione dhe kombinime. Në *Tristes Tropiques*, kur ai e lidhte marksizmin dhe impulse të tjera kryesore të zhvillimit të tij intelektual dhe të konceptit të tij të etnografisë, ai preokupohej nga e njëjta pyetje kryesore: “Atë të raportit midis ndjenjës dhe arsyes, eksperiencës dhe racionalitetit, dhe synimi ishte i njëjtë: të arrihej një lloj super-racionalizmi, i cili do të integronte të parën me të dytën pa sakrifikuar asnjë karakteristikë të saj.”⁴

Kjo mund të jetë një mënyrë shumë abstrakte për të thënë se marksizmi ishte një etiologji, një përpjekje për të ndjekur gjurmët e kushteve të shoqërisë, të ambientit material dhe të ndërjegjës njerëzore në burimet e tyre të fshehura. Marrëdhëniet sociale dhe përfaqësimet kolektive janë koordinatat parësore të teorisë së Lévi-Strauss-it, i cili sugjeron më tej se vetë marksizmi është veçse një rast i pjesshëm i një teorie më të përgjithshme të komunikimit. Kjo teori do të jetë korniza e një sociologjie vërtet racionale dhe gjithëpërfshirëse. Jo rastësisht, marksistët i kanë kritikuar pretendimet e teorisë së Lévi-Strauss-it dhe kanë sulmuar aspektet e saj “iracionale” dhe “anti-historike”.

1 Jean-Paul Sartre, *Critique de la Raison Dialectique* (Paris: Gallimard, 1985), 490-93.

2 Jean-Paul Sartre, “L’anthropologie,” in *Situations* (Paris: Gallimard, 1972), 9:83-89.

3 Paul Ricoeur, *Le conflit des interpretations: essais d’hermeneutique* (Paris: Seuil, 1969), 37.

4 Claude Lévi-Strauss, *Tristes Tropiques* (Paris: Plon, 1955), 62.

Nuk mjaftonte, pra që thjesht të përcaktoheshin strukturat farefisnore apo kornizat mendore; ishte po aq i rëndësishëm procesi nëpërmjet të cilit janë prodhuar dhe riprodhuar këto. Nëpërmjet farefisnisë Lévi-Strauss-i kishte trajtuar këtë çështje duke theksuar reciprocitetin dhe martesën ndër-kushërinj. Duke e anashkaluar atë në studimet e tij të intelektit, me formulën e “formës që imponohet mbi përmbajtjen”¹ Lévi-Strauss-i mendohet të ketë rënë vetë viktimë e metodologjisë së vetë.²

Gjithsesi, nëse metodat e Lévi-Strauss-it dhe Marx-it theksojnë forcën determinuese të strukturave të fshehura, sot kjo mund të quhet jo më shumë se një truizëm shkencor. Strukturalizmi duket se ia mohon domethënien fenomeneve sipërfaqësore si për shembull veprimeve dhe praktikës sociale pasi e konsideron domethënien si një aftësi të strukturës së thellë dhe si të pa-modifikueshme nga eksperiencia. Divorci i analizës strukturale në formën e saj Lévi-Strauss-ian nga këto diskutime, ashtu si edhe divorci i vetë strukturës nga format sociale dhe kulturore që supozohet të jenë mbartësit e tyre, mendohet të rezultojë si pasojë e përkushtimit a priori të Lévi-Strauss-it ndaj ideologjisë së Saussure-it.³ Zhvendosja e konceptit të strukturës jashtë konstrakteve kulturore konkrete do të thotë në fakt se sistemet sociale apo kulturore janë me përkufizim të ndara nga çfarëdolloj marrëdhënie me ndërgjegjen subjektive, domethënien interpretative, aktet sociale apo organizimi social. Këto ndarje pra konvergojnë me kontrastet thelbësore të ideologjisë linguistike të Saussure-it, inter alia ndarja e mendimit nga veprimi, kulturës nga shoqëria, paradigma nga sintagma, teksti nga konteksti, struktura nga procesi historik dhe subjektiviteti nga strukturat e ndërgjegjes.

Për më tepër, duke konsideruar se Lévi-Strauss-i huazoi përfundimet esenciale të analizës strukturale nga linguistika, kritikët e shohin si paradoks që gjuha, tematika kryesore e fushës së linguistikës, nuk u përfshi fare në imagjinatën e tij. Disa thonë se ashtu sikurse edhe Durkheim-i, ai dështoi t’i jepte zgjidhje kritikës së linguistikës historike se metoda komparative paraqet metodën më të përafërt “shkencore” të mundur në shkencat shoqërore.⁴ Të tjerë mendojnë se ai nuk e konsideron fare gjuhën si sistem komunikimi nëpërmjet të cilit krijohen dhe manipulohen simbolet në procese si bindja apo qortimi, kërkimi i mbështetjes në mendim, katarzit, shijimit, apo përpjekjet për të kuptuar situata të ndryshme. Në shpjegimet e tij nuk ka shumë vend për ndjenjat, për mrekullitë, gëzimet, dhimbjen dhe dashurinë. Edhe pse gjithmonë i preokupuar me domethënien, ai supozonte të reduktonte semantikën në thjesht një vegël për të zbuluar strukturat binare. Vepra e tij bazohet në universalizmin e metaforës, e megjithatë ai e trajton metaforën si një realitet, si një element përbërës të strukturës së trurit dhe jo si një prodhim të fuqishëm të gjuhës.⁵ Shumica e konsiderojnë këtë si një model të keqkuptuar të strukturës linguistike së bashku me një ndarje të mitit nga produkte të

1 Claude Lévi-Strauss, “Histoire et ethnologie,” in *Anthropologie structurale* (Paris: Plon, 1949), 28.

2 Gary Roth, “Claude Lévi-Strauss in Retrospect,” *Dialectical Anthropology*, 18 (1993), 31-42.

3 Terence S. Turner, “On Structure and Entropy: Theoretical Pastiche and the Contradictions of Structuralism,” *Current Anthropology*, 31 (1990), 563-68.

4 Regna Darnell, “The Structuralism of Claude Lévi-Strauss,” *Historiographia Linguistica: International Journal for the History of the Language Science*, 22 (1995), 217-34.

5 Leacock, “Structuralism and Dialectics.”

tjera gjuhësore me të cilat presupozohet të përputhen pikëpamjet mekanistike të Lévi-Strauss-it mbi sistemet sociale.

Në këtë vrashtë kritikë ndeshim edhe një mbyetje të çështjes së ritualit. Akuza nga antropologë britanikë si Victor Turner është se përqendrimi ekskluziv mbi simboliken dhe mendimin lë mënjanë realitetin e gjendjes ekstreme të ndjenjave që përjetohen gjatë aktiviteteve sociale si ritualet, të cilat nuk mund thjesht të reduktohen në modalitete të intelektit.¹

Mbi të gjitha, kritikët fokusohen edhe në faktin se duke përcaktuar rolin e vecantë të antropologjisë, Lévi-Strauss nuk përfshin fare proceset sociale si shfrytëzimin, alienimin, ndarjen ekstreme të detyrave të punës, luftën moderne dhe karakterin e shtetit.² Duke marrë parasysh afërsinë me Marksizmin, Lévi-Strauss pritej që të kërkonte për bazat e strukturave universale në cilësinë e jetës materiale, jo vetëm të aktiviteteve ekonomike por në dimensionin e plotë të jetës sociale që përbënte pëlhurën e aktivitetit njerëzor.³ Por duke kontribuar në rimëkëmbjen e antropologjisë Marksiste dhe kritikës letrare, ai në fund i shpërfilli të dyja këto. Dhe pavarësisht pretendimeve të tij për kalimin nga preokupimet infrastrukturore në ato superstrukturore, ai në fakt qortohet që nuk u përfshi në asnjërën nga këto.

Etja e tij për absoluten supozohet t'i shpëtojë realitetit tonë ose, mbase të konsiderojë këtë si një rastësi. Me sa duket, në ciklin e tij *Mitologjikat*⁴ marëdhënia ndërmjet miteve dhe njerëzve që i përdorin ato analizohen shumë rrallë dhe këndvështrimi struktural kritikohet që e konsideron mitin thjesht si një manifestim të logjikës mbështetëse të një sistemi i të cilit bën pjesë, i arritjeve dhe tragjedi, i eksperiencave të përsëritshme me forcat dhe lëvizjet e mahnitshme dhe të frikshme, dhe më pak nga të gjitha me dramën që përbëjnë komunikimin njerëzor. Komplexiteti magjepsës i gamës së gjerë së kërkimeve të Lévi-Strauss-it në tematikën e miteve thuhet të ketë maskuar faktin që ai ka izoluar dhe ngushtuar seriozisht qëllimin e kësaj pune kërkimore, për sa i përket një teorie të përgjithshme mbi shoqërinë.

Lévi-Strauss-i gjithashtu thuhet të ketë denaturuar mendjen njerëzore duke e reduktuar atë në një makinë për të prodhuar rregulla logjike. Nëse mitet mund të shpjegojnë gjithçka, kritikët pyesin nëse logjika e tyre ka karakterin e intelektit. Në fakt sipas kritikëve të Lévi-Strauss-it, duket sikur ai flet veçse për çifte të kundërtash dhe transformimin nga një nivel në tjetrin nëpërmjet një qasjeje që duket shumë mekanistike. Procedurat teknike të analizave strukturale që mohojnë domethënien në nivelin e veprimit përfaqësojnë diskutime të miteve nga më intelektualiste dhe abstrakte ndër shkollat e mendimit më gjerësisht. Thuhet se qasja e Lévi-Strauss-it në përgjithësi duket të na çojë më larg dhe jo më në brendësi të çështjeve të raporteve

1 Victor w. Turner, *The Ritual Process: Structure and Anti-Structure, The Lewis Henry Morgan Lectures*, 1966 (Chicago: Aldine, 1969).

2 Diamond, "The Inauthenticity of Anthropology."

3 Roth, "Claude Lévi-Strauss in Retrospect."

4 Claude Lévi-Strauss, *Le Cru et le Cuit* (Paris: Plon, 1968); *Du miel et du cendres* (Paris: Plon, 1966); *L'origine des manieres de table* (Paris: Plon, 1968); *L'homme nu* (Paris: Plon, 1971).

midis mitologjive dhe sistemeve sociale dhe për transformimet e këtyre raporteve ndërkohë që ndryshojnë sistemet sociale.

Për më tepër, për arsye se seksualiteti feminin dhe dëshirat e grave janë të shpërfillura nga teoria e tij e farefisnisë, Lévi-Strauss-i u përball me shumë kritika nga feministet amerikane të cilat filluan të fitojnë popullaritet në antropologji në vitet 1970. Në veçanti kapitulli i Gayle Rubin-it u shndërrua në një kritikë klasike feministe e qendrimit strukturalist, dhe e paraqiste kontributin e Lévi-Strauss-it në tërësi si reaksionar.¹ Më tej, ndërsa në vitet 1970 feministet e konsideronin *Strukturat Elementare të Farefisnisë*² si një trajtim të seksizmit, ai konsiderohet edhe si homofobik nga lëvizjet e mëvonshme për të drejtat e homoseksualëve për t'u martuar dhe për pasur fëmijë.³

Sado detaje mund të ketë trajtuar Lévi-Strauss-i në kornizën e tij analitike, forcat motivuese pas këtij procesi mbeten të pakuptueshme dhe procedurat e tij arbitrare, edhe pse nganjëherë shumë sqaruese.⁴ Edhe *Tristes Tropiques*⁵ janë kritikuar shumë nga teoristët e studimeve kulturore për pothuajse gjithçka, që nga racizmi deri tek një thjeshtëzim i tropeve të udhëtimit dhe të punës në terren!⁶ Disa autorë si Jack Goody-i apo Jacques Derrida-ja akuzojnë Lévi-Strauss-in për përdorimin e kategorizimeve etnocentrike,⁷ por padia e racizmit është thjesht e pavënd. Një ekzaminim i plotë dhe rivlerësim i të gjitha kritikave të Lévi-Strauss-it është e pamundur në këtë artikull. Gjithsesi, duhet thënë se stili parodik dhe potpuri është goxha popullor ndër kritikuesit e Lévi-Strauss-it.

Antropologu si hero

Duket se aktualisht ka një keqkuptim total të qendrimit të Lévi-Strauss-it në antropologjinë bashkëkohore amerikane, ku e thënë troç, ai duket të jetë pranë mospërfilljes pasi shumica e antropologëve praktikanë nuk e ndjejnë veten aspak të influencuar nga kjo qasje. Më së shumti, Lévi-Strauss-i lexohet në kontekstin e historisë së antropologjisë dhe aty ai shpesh herë hidhet

1 Gayle Rubin, "The Traffic in women: Notes on the Political Economy of Sex," in *Toward an Anthropology of Women*, ed. Rayna Reiter (New York: Monthly Review Press, 1975), 157-210.

2 Claude Lévi-Strauss, *Les structures élémentaires de la parenté* (Paris: Mouton, 1967)

3 Jeanne Favret-Saada, "La pensée Lévi-Strauss," *Journal des Anthropologues*, 82-83 (2000), 53-70; Patrice Maniglier, "L'humanisme interminable de Claude Lévi-Strauss," *Les Temps Modernes*, 609 (2000), 216-41.

4 Jeanne Favret-Saada, "La pensée Lévi-Strauss," *Journal des Anthropologues*, 82-83 (2000), 53-70; Patrice Maniglier, "L'humanisme interminable de Claude Lévi-Strauss," *Les Temps Modernes*, 609 (2000), 216-41.

5 Lévi-Strauss, *Tristes Tropique*.

6 James Clifford, *Routes: Travel and Translation in the Late Twentieth Century* (Cambridge, Mass.: Harvard University Press, 1997).

7 Jack Goody, *The Domestication of the Savage Mind* (Cambridge: Cambridge University Press, 1977); Jacques Derrida, de la grammatologie.

poshtë, kjo, për ironi, pikërisht për atë arsye për të cilën ai duhet lavdëruar. Me fjalë të tjera, ai kritikohet për insistimin e tij në rigorozitetin shkencor, thjesht pasi ky koncept fatkeqësisht është i huaj për shumë antropologë amerikanë. Rezultati i kësaj situatë është më pak një kritikë e vazhdueshme e Lévi-Strauss-it sesa një neglizhim i shkujdesur. Thënë më troç, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Britani sot shpesh studentët pasuniversitarë të antropologjisë nuk lexojnë fare nga Levi-Strauss-i. Ai pothuajse nuk përmendet fare në seminare e leksione, gjë që është një veprim tragjik dhe dritëshkurtër për fushën e antropologjisë. Më tej, më dramatikja është se shumica e antropologëve amerikanë gjatë tre dekadave të kaluara as që mendojnë se Lévi-Strauss-i është aq i rëndësishëm sa për argumentuar me të. Shumë shkurt ai shpërfilltet në praktikën e përditshme të lëndës që në përgjithësi ka përfaquar postmodernizmin.

“Tropetë e trishta” të postmodernëve kanë parë empiricizmin dhe historicizmin si një problem të sinqertë dhe të mirënjohur, kryesisht nëpërmjet një qëndrimi shpërfillës ndaj analizës shkencore dhe një përvetësimi jo-kritik të kritikës letrare.¹ Nuk është e habitshme që në këto kushte teoritë e Derrida-së kanë kapur sidomos departamentet e letërsisë së Amerikës Veriore. “Dekonstruktimi” i tij i transplantuar përtej Atlantikut nga një grup kërkimesh filozofike evropiane dhe praktikuar mbi terrenin e komenteve letrare amerikane, po fillon të duket sa vjen e më amerikan sesa francez. Edhe në Evropë shpesh kjo perceptohet si një grup teoremash amerikane, një diskurs apo një shkollë që sa vjen e njihet si një shpikje amerikane. Kjo, gjithsesi, nuk nënkupton vetëm se dekonstruksioni është thjesht një “diçka” amerikane, por për më tepër se vetëm në Amerikë ky lloj dekonstruksioni kuptohet si “diçka”. Me fjalë të tjera, nuk është se vetëm në Amerikë ekziston diçka si dekonstruksioni, por se vetë Amerika është dekonstruksioni i Evropës.²

Nuk është çudi atëherë që ekzistojnë dhe që do të ketë një numër në rritje të studiuesve, të cilët kanë zgjedhur drejtime të tjera dhe që punën e tyre e kryejnë pa marrë parasysh përfundimet e Lévi-Strauss-it në kontekstin e zhvillimeve të reja në antropologji në mbarë botën. Por kjo nuk vë në pikëpyetje vlerën e tij bashkëkohore dhe rëndësinë e tij të veçantë për të ardhmen, as nuk i jep kjo shpjegim trajektores negative që ka marrë reputacioni i Lévi-Strauss-it sidomos në antropologjinë kulturore amerikane. Shumica e antropologëve janë të pakënaqur me këtë situatë dhe teoria e Lévi-Strauss-it në fakt është pritur në antropologji me më shumë kujdes dhe padyshim në kontrast me reagimet kritike që tekstet e para të antropologjisë strukturale i shkaktuan një sërë recensuesve, më të gatshëm për të hedhur poshtë presupozimet e tyre filozofike sesa të gjykonin impaktin e tyre në fushën e antropologjisë, të cilën nuk e mbizotëronte asnjëri prej tyre.

1 Nicole Polier and Èilliam Roseberry, “Tristes tropes: Post-modern Anthropologists Encounter the Other and Discover Themselves,” *Economy and Society*, 18 (1989). 245-64.

2 Anselm Haverkamo (ed.), *Deconstruction is/in America* (New York: New York University Press, 1995), 28. Anselm Haverkamo (ed.), *Deconstruction is/in America* (New York: New York University Press, 1995), 28.

Lévi-Strauss ishte vërtet një eksplorues që kërkonte rrugën e tij në një ambient të ri: një botë e re e mitit dhe imagjinatës. Në këtë aspekt, puna e tij kishte të bënte me analizën e përmbajtjes së miteve si dhe të proceseve mendore që i mundësonin ato. Për arsye se këto përmbajtje mitike dhe procese mendore kishin qenë tematika studimi të interpretimeve alegorike Frazeriane apo spekulimeve Frojddjane, shkrimet e Lévi-Strauss-it fituan një rëndësi përtej botës imediate të kërkimit antropologjik. Letrarë, psikologë, historianë, dhe filozofë u ndjenë të detyruar të ballafaqoheshin me pikëpamjet radikale të Lévi-Strauss-it, por fakti që shumica e këtyre dishepujve dinin pak për teknikalitetet e sistemeve farefisnore, ekzigjencat e xhunglës në Brazil, apo debatet rreth organizimit dualist si dhe çështje të tjera të ngjashme bëri që Lévi-Strauss-i vetë të shndërrohej në një figurë mitike.

Për shumë veta, teoritë e Lévi-Strauss-it janë ende shumë “intelektualiste” dhe pengojnë të kuptohet mrekullia e veprimit dhe praktikës njerëzore. Por kjo kritikë është njësoj sikur dikush të ngrihej kundër teorisë kinetike të gazrave nën pretekstin se duke shpjeguar pse ajri i nxehtë hollohet dhe shkon lart, vihet në rrezik jeta e familjes dhe morali i vatrës, ngrohtësia e së cilës do të humbiste rezonancën e saj simbolike dhe emocionale. Ose, me një shembull tjetër, sikur fakti i njohjes sesi punon ora nga brenda do të na pengonte të kuptonim se çfarë roli mund të luante ora në jetën emocionale personale, ose nëse formula kimike e sheqerit do të na privonte nga shijimi i shijes së tij dhe, përkundrazi, do të na bënte të preferonim një shije të kripur në vend të së ëmbëlës.

Shpirtrat sensibël refuzojnë të kuptojnë se nuk janë emocionet ato që prodhojnë kulturën, por e kundërta, ashtu sikurse muzika është një kombinim matematik me valë të ndryshme që krijon emocione rezultat i të cilave nuk është. Me insistimin e tij mbi ndarjen e mprehtë midis ndërgjegjes individuale dhe asaj kolektive, Durkheim-i nuk arriti t'i japë theksin e duhur mundësisë për të kuptuar tërësisht faktet sociale. Kjo korrespondoi, sipas Lévi-Strauss-it me një të metë të shkencës sipas së cilës tiparet subjektive janë lënë në një anë ndërkohë që ne kërkujmë shpjegime në forma tërësisht objektive. Me konceptin e tij të “fakteve sociale totale”, Mauss-i nënkuptoi se në të kundërt kjo dikotomi e thjeshtë dhe e volitshme është e papranueshme për sociologjinë:

“Në mënyrë që të kuptojmë një fakt social total është e nevojshme ta kuptojmë atë totalisht, pra nga pikpamja e jashtme si një dicka, por si një dicka pjesë integrale e së cilës është botëkuptimi subjektiv, njëkohësisht i ndërgjegjshëm dhe pandërgjegjshëm që kemi për atë sikurse për të kuptuar të qenurit njeri ne duhet ta jetojmë këtë fakt ashtu sikurse e jeton një indigjenas, në vend që ta vëzhgojmë atë si etnografë.”¹

1 Claude Lévi-Strauss, “Introduction a l'oeuvre de Marcel Mauss,” in Marcel Mauss, *Sociologie et Anthropologie* (Paris: Presses Universitaires de France, 1950), xxviii.

Ashtu sikurse ideali i një kimie totale e cila “duhet të shpjegojë jo vetëm formën dhe shpërndarjen e molekulave të një luleshtrydheje, por sesi shija e veçantë rezulton nga kjo formë,” Lévi-Strauss-i është përpjekur t’i mari gjërat seriozisht, duke i treguar vetes që ato janë objekte që kërkojnë analizë të gjatë dhe shumë të duruar.¹ Miti, për shembull, është një realitet *sui generis* që mund dhe duhet të studiohet në vetvete, pa iu referuar një konteksti të caktuar, qoftë ky historik, psikologjik apo sociologjik. Mitet ‘janë ushtrimi i mendjes së egër; uniteti i tyre i brendshëm dhe logjika e tyre koherente nuk ndodhen në anën e ngjashmërisë apo të referencës.”²

Interpretimi teorik i Lévi-Strauss-it, bazuar në zbardhjen e veprimeve të mendjes njerëzore, realizoi një raport midis natyrës dhe kulturës, sidomos në studimin e sistemeve të farefisnisë dhe të prodhimit të miteve. Origjinaliteti i tij qëndronte tek sfida që ai i bëri dilemës së kundërvënies konceptuale të papërputhshme të natyrës njerëzore dhe kulturës, ku ai u përpoq të tregojë se njëra mbështet tjetrën në të njëjtën mënyrë që një strukturë abstrakte dhe homogjene kontrollon manifestime konkrete dhe të ndryshme. Ky parim nuk është i ri, por është mbajtur rezervë nga antropologjia filozofike tradicionale, por njohuria etnografike moderne e ka vënë në pikëpyetje. Lévi-Strauss-i kishte marrë përsipër një detyrë: t’i rikthehej këtij parimi dhe të sfidonte empiricizmin etnografik duke u munduar njëkohësisht të identifikonte ligje të mendjes njerëzore që shprehen nëpërmjet fushave si farefisnia, miti, arti, dhe format “primitive” të klasifikimit, pra për të shpjeguar më së miri karakteristikat kulturore dhe për të vendosur bashkimin intelektual të njerëzimit.

Kritika në përgjithësi i jepte Lévi-Strauss-it mundësi për të ngulmuar në bindjen e tij se shkencat sociale dhe antropologjia, duke ndjekur metodologjinë e shkencave natyrore, duhet të kuptojnë se realiteti i objektit të tyre të studimit nuk është plotësisht i kapshëm nga syri vëzhgues. Kjo është e qartë sidomos në “finalen” e ciklit “Mitologjike”, që mund të shihet si mbrojtje e zgjatur e metodës strukturale. Në përpjekjen e tij për të qartësuar divergjencat e tij nga filozofët e të njëjtit subjekt ai predikonte një humanizëm të përcaktuar më pak nga kultura e një momenti të caktuar historik dhe konfirmoi, kundër kritikës marksiste, besnikërinë e tij ndaj Marksit dhe shpirtit dialektik të materializmit historik. I edukuar si filozof, ai në të vërtetë nuk e abandonoi asnjëherë filozofinë, pavarësisht protestave të tij për të kundërtën, dhe shkroi kritika të rëndësishme të ekzistencializmit dhe fenomenologjisë. Në retrospektivë duket qartë natyra dhe masa e sfidës së antropologjisë së Lévi-Strauss-it ndaj filozofisë. Kritikata e shumëllojshme të ngritura kundër strukturalizmit, reduksionizmit të tij, antihumanizmit të tij, dhe anti-historicizmit të tij, të gjitha janë të kundërshtuara, të riformuluara dhe të kthyer sërish si kritikë ndaj filozofisë për: mungesën e njohurisë shkencore, etnocentrizmin dhe antropocentrizmin e saj dhe obsesionit të saj me historinë.

Siç na kujtonte edhe Leach-i, rëndësia e Lévi-Strauss-it qëndronte në mënyrën e ligjëritimit që kishte krijuar për të shpalosur fakte dhe mënyra shpjegimi dhe idesh, duke sugjeruar gjithmonë mënyra të pazakonta për të shikuar fakte shumë të zakonata,

1 Claude Lévi-Strauss, *ibid.*, xxvii.

2 Marcel Henaff, Claude Lévi-Strauss et l’anthropologie structurale (Paris: Belfond, 1991), 171.

dhe kështu provokonte mendimin mbi bazat e dijes.¹ Në një kapitull të mahnitshëm mbi “totemin dhe kastën,” për shembull, Lévi-Strauss-i vendos të tregojë se struktura e sistemit të kastës në Indi është një transformim logjik i strukturës së rregullit totemik të indigjenasve australianë.² “Fishekzjarre intelektuale” e këtij lloji, sipas Leach-it, vetvetiu nuk na zgjerojnë botëkuptimin tonë të rregullit të kastës apo të totemizmit australian, por ato na ftojnë të mendojmë më thellë mbi shoqërinë njerëzore dhe për atë çka është në veçanti më njerëzore.³ Sipas pikëpamjes së Lévi-Strauss-it është më e rëndësishme të kuptosh dallimin midis kulturës dhe natyrës sesa të merresh me argumenta skolastikë si për shembull, sesi despotizmi oriental ka ngjashmëri me feudalizmin në çfarëdo sekuence të determinizmit historik.

Me konstatimin e tij se satisfaksioni mendor është produkt i gjërave “të mira për t’u menduar,”⁴ ai e çoi antropologjinë drejt një metode më formale dhe më shkencore, dhe pa dashje ndezi një entuziazëm intelektual që përshkoi pothuajse tërë shkencat sociale dhe filologjike dhe u bë, në fjalët e Susan Sontag-ut, antropologu i parë hero.⁵ Por nuk është vetëm kërkimi formalist për çiftet e kundërta që është me të vërtetë i vlefshëm ashtu sikurse nuk janë faktet e çuditshme apo shpjegimet akoma më të çuditshme që ka sjellë Lévi-Strauss-i dhe që e bëjnë atë një hero intelektual. Sipas Clifford Geertz-it, asnjë antropolog nuk ka qenë më insiutes sesa Lévi-Strauss-i në faktin se “praktika e profesionit të tij përbëhet nga një kërkim personal i drejtuar nga një vizion personal dhe që synon shëlbimin personal.”⁶ Në formën e mitit standard profetik të një kërkimi heroik me antropologun si hero, sipas Richard Shweder-it, Lévi-Strauss-i e shndërroi ekspeditën e tij në brendësinë e virgjër të Amazonës në një kërkim vizioni dhe e shndërroi antropologjinë në një mision shpirtëror për të mbrojtur njerëzimin kundër vetvetes.

Për këtë arsye Lévi-Strauss-i admirohet jo dhe aq shumë për idetë e reja sesa për originalitetin e guximshëm me të cilin i aplikoi ai ato në një gamë të gjerë lidhjesh. Ky kompleksiteti shfaqet si diçka që nxjerr shumë gjëra në dritë në vend që të krijojë konfuzion. Është organizimi i ideve të Lévi-Strauss-it që krijon faktet “si një ciklotron që krijon pjesëzat përbërëse të atomit.”⁷ Pa dyshim që ai do të kujtohet për shumë gjëra, përfshi këtu edhe aftësitë e tij si një punues kërkimor shumë i kujdesshëm, që i zotëronte detajet në mënyrë të paprecedent, dhe si një studiues, i cili nuk përtoi asnjëherë t’u përgjigjej kritikëve dhe, i cili herë herë korigjonte idetë e tija kur e ndiente se kritika ishte serioze dhe e fuqishme. Sidoqoftë, vepra e Lévi-Strauss-it është përfundimisht e çuditshme dhe më shmangëse sesa duket. E rrënjosur në racionalizëm ajo është ndërtuar mbi një Rusoizëm paradoksal, por e gjallëruar nga një ironi e mugët e një

1 Leach, *Claude Lévi-Strauss*.

2 Claude Lévi-Strauss, *La pensee sauvage* (Paris: Plon, 1962), 144-77.

3 Leach, “Telstar et les aborigènes ou la Pensee sauvage,” 111.

4 Claude Lévi-Strauss, *Le totemisme aujourd’hui* (Paris: Presse Universitaires de France, 1962), 132.

5 Nelson E. Hayes and Tanya Hayes (eds.), *Claude Lévi-Strauss: The Anthropologist as Hero* (Cambridge, Mass: Massachusetts Institute of Technology Press, 1970).

6 Geertz, *The Interpretation of Cultures*, 346.

7 Diamond, “The Inauthenticity of Anthropology.”

“pesimizmi aktiv.” Ndërsa të tremb me forcën e tij radikale, të mahnit me delikatesën e mënyrës së tij të të bërit të gjërave dhe të pushton me mendjemprehtësinë me të cilën imponon logjikën e tij. Shkruar për të të bërë për vete, vepra e Lévi-Strauss-it është padyshim bazuar në rigorozitetin e paqortueshëm shkencor dhe akademik. Në të njëjtën kohë, ajo shprehet në një prozë evokuese, poetike dhe të kulluar në kalimet e saj më të vështira, e lëkundshme dhe e lehtë edhe në rrugën e saj më lineare dhe të përcaktuar. Është plot me shije të ndryshme, ndjenja shumëngjyrëshe, thurur me kënaqësitë e të shkruarit dhe sa vjen e më e frymëzur nga një prezencë e rëndësishme.